



Pranimi / Dostizur Prilaz / Prilaz Received / Delivery	20.04	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKAMSHIK	3719/2023		114	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.466/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.466/2023 të datës 07.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Garibaldi" Nr.17/4, Kati 4, në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit Nr.12/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Autoritetit të Konkurrencës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.466/2023 e datës 07.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.12/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 06.03.2023 përmes poste ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimet Civil është pranuar me datë 07.03.2023 nën shenjë A.nr.466/2023 dhe numër protokoll:2447/2023, kundër Vendimit Nr.12/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës me pretendimin e vetëm ankimor se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të ankuesit në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që të gjitha dokumentet e kërkuar sipas konkursit i kam bashkangjitur me rastin e aplikimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 15.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Autoriteti i Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Ndërsa me datën 31.03.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankesë administroi këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2447/2023 të datës 07.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Zarkin postar me shifër R2915305; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Ankesën e ankuesit të datës 10.02.2023; Vendimin Nr.12/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës; Konkursin e datës 02.12.2022; Diplomën e ankuesit të datës 15.07.2014; Kontratën e punës së ankuesit tek Smart Center; Vërtetimin e datës 12.10.2022 me numër ref:282/2022; Vërtetimin e datës 12.10.2022 me numër ref:281/2022; Vërtetimin e datës 12.10.2022 me numër ref:280/2022; Vërtetimin e datës 11.12.2014; Çertifikatën e datës 15.06.2014; Çertifikatën e datës 06.12.2008; Çertifikatën e datës 19.06.2008; Çertifikatën e datës 09.11.2007; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.03.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 31.03.2023; Deklaratën e anëtarëve të Komisionit të Pranimit të datës 31.03.2023; Vendimin për themelimin e komisionit të pranimit i datës 20.12.2022; Akt emërimit e datës 01.10.2019; Akt emërimit e datës 07.12.2018; Akt emërimit e datës 07.12.2018 me numër 433/18-04/6; Akt emërimit e datës 07.12.2018 me numër 433/18-04/8; Akt emërimit e datës 30.12.2022 me numër 389/22-06/0; Lista e aplikantëve; CV-ja e ankuesit; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; E-mailin e datës 29.03.2023 dërguar nga I.Z për A.K dhe Formularin e vlerësimit të jetëshkrimit të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Autoriteti i Konkurrencës të Republikës së Kosovës me datën 02.12.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm me numër të referencës RN00010521 lidhur me pozitë "Asistent administrativ 3" në kuadër të Sektorit të Arsimit të Komunës së Obiliqit, me kriteret e përcaktuara si në vijim:

*Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to dhe Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet .*

Kolegji i Këshillit sipas shkresave të lëndës, ka gjetur se në konkursin e shpallur ka aplikuar edhe ankuesi i cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa në testin me shkrim kishte arritur 49 pikë, ndërsa për jetëshkrimin është vlerësuar me gjithsejtë 7.6 pikë dhe si rrjedhojë nuk kishte arritur të grumbulloi gjithsejtë 60 pikë sa është e nevojshme për të iu nënshtruar edhe intervistës me gojë.

Ankuesi i pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve dhe renditjes së kandidatëve, me datë 10.02.2023 ka parashtruar ankesë kundër Njoftimit për vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit me pretendimin ankimor se nuk është vlerësuar sikurse parashikohet dispozitat e ligjit material, gjegjësisht nenit 22 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa me datë 14.02.2023 Komisioni i Pranimit ka nxjerrë vendimin me shifër 12/2023 dhe numër protokollit 61/23-13/D përmes të cilit ka ri

konfirmuar totalin e pikëve të ankuesit ndërsa ka lënë të kuptohet se ankesa e të njëjti është e pabazuar. Tutje, Komisioni i Pranimit nëpërmjet deklaratës së përbashkët të datës 31.01.2023 ka theksuar faktin se ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit dhe kandidatëve të tjerë në procedurë të rekrutimit është përdorur standard i njëjtë i vlerësimit, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 7.2 pikë, kurse sipas formularit të renditjes përfundimtarë të kandidatëve, vlerësimi maksimal që i është bërë ndonjë kandidati në këtë fazë është 14.9 pikë.

Me qëllim të shqyrtimit të mëtejshëm të pretendimit ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 dhe 4 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë,..."* dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi sipas formularit të vlerësimit nga pikët e mbledhur të testit me shkrim 49 pikë dhe vlerësimit të jetëshkrimit prej 7.2 pikësh ka arritur të grumbulloi gjithsej 56.2 pikë, nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur të kaloi pragun për të iu nënshtuar intervistës me gojë sikurse përcaktohet me nenin 23 paragrafi 2 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë"*.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Komisioni i Pranimit nuk e ka vlerësuar mjaftueshëm ankuesin sa i përket jetëshkrimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se në kuptim të dispozitave të nenit e nenit 22 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"*, bëhet fjalë për vlerësimin maksimal që mund të ketë një kandidatë, dhe jo detyrimisht secili kandidatë duhet të vlerësohet me gjithsej me 20 pikë sikurse përcaktohet në paragrafin 4 i së njëjtës rregullore: *"4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë"* ngase për të tri fushat e vlerësimit të kësaj faze sikurse janë niveli i arsimimit, përvoja domethënëse në punë dhe trajnimet përdoret termi "deri" nga rrjedh se dispozitat e ligjit material ia kanë njohur të drejtën e vlerësimit diskrecional Komisionit të Pranimit, mirëpo çdo herë duke respektuar parimet dhe rregullat e përgjithshme të pranimit të përcaktuara sipas nenit 22 paragrafi 5 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve"*.

Prandaj, sikurse u tha më lartë, mbi bazën e shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si dhe analizimin e dispozitave ligjore të ligjit material dhe rregullores së lartcekur, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit është e pabazuar, prandaj si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit konstaton se në procedurë e pranimit sipas konkursit me Nr. reference RN00010521 për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën e punës "Zyrtar Administrativ", çështja e vlerësimit të jetëshkrimit të ankuesit nuk është përcjellë me shkelje procedurale.



Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.466/2023

**Flakron Gashi**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Eshref SHABANI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretarit të Autoritetit Rregullativ të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin Rregullativ të Republikës së Kosovës
- Arkivit të KPMSHCK-së.